

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 6 nga Ligji për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM- së" nr.5/02), dhe konformë nenit 16, paragrafi 1, pika 1 dhe 4 nga Statuti i Komunës së Kërçovës ("Fletorja zyrtare e Komunës së Kërçovës" nr. 5/2006), ndërsa në lidhje me nenin 46, paragrafi 1, neni 45, 47 dhe 48 nga Ligji për tokën ndërtimore, ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16 dhe 190/16), ndërsa në lidhje me nenin 20, paragrafi 1, 2 dhe 3 nga Ligji për planifikim hapësiror dhe urban ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr.199/14, 44/15, 193/15, 31/216 dhe 163/16), neni 1, paragrafi 1 dhe neni 3, paragrafi 3 nga Ligji për mjedisin jetësor ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 53/2005, 81/2005, 24/2007, 159/2008, 83/2009, 48/2010, 124/2010, 51/11, 123/12, 93/13, 187/13, 42/14, 44/15, 129/15 dhe 192/15), ndërsa në lidhje me nenin 3 nga Ligji për veprimtari komunale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 95/12, 163/13, 42/14, 44/15, 147/15, 31/16, 64/18 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 302/20) dhe Rregulloren për nivelin e rregullimit të tokës ndërtimore në bazë të shkallës së rregullimit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 193/16, 72/18 dhe 16/22), Këshilli i Komunës së Kërçovës në mbledhjen e mbajtur më dt. _____, solli:

P R O G R A M

PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE PËR HAPËSIRËN E KOMUNËS SË KËRÇOVËS PËR VITIN 2026

PËRMBAJTJA:

PËRMBAJTJA.....	1
1. HAPËSIRA QË ËSHTË LËNDË E RREGULLIMIT.....	2
2. VËLLIMI I PUNËVE PËR PËRGATITJE DHE PASTRIM TË TOKËS NDËRTIMORE.	2
3. VËLLIMI DHE SHKALLA E PAISJES TË TOKËS ME OBJEKTE TË INFRASTRUKTURËS KOMUNALE.....	5
4. BURIME PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT.....	7
5. LLOGARITJE E SHPENZIMEVE PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE	7
6. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE DHE SHPËRNDARJA E TIJ	8
7. MËNYRA E NDARJES SË MJETEVE PËR FINANCIMIN E NDËRTIMIT DHE MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURËS.....	13
8. KUFINJTË E ZONAVE PËR PAGESË TË KOMPENSIMIT PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE.....	22
9. DINAMIKA E REALIZIMIT TË PROGRAMIT	22
10. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE.....	23

1. HAPËSIRA QË ËSHTË LËNDË E RREGULLIMIT

Si hapësirë që është lëndë e rregullimit, llogaritet toka e ndërtuar dhe pa ndërtuar në rajonin e Komunës së Kërçovës, e cila është shpallur si rajon ndërtimor i paraparë për ndërtim, në pajtim me Planin e përgjithshëm urbanistik (PPU) dhe Planin detal urbanistik (PDU) të Komunës së Kërçovës dhe Dokumentacionin urbanistik për vendbanimet (DUVB).

Në vitin 2026, Komuna e Kërçovës vëmendje të veçantë do t'i kushtojë rregullimit dhe pajisjeve të tokës ndërtimore në pajtim me detyrat e programuara nga vitet parake, të cilat deri tash nuk janë realizuar dhe në detyrat për rregullimin e tokës ndërtimore të cilat filluan në vitin e kaluar, ndërsa u lanë që të kryhen këtë vit dhe prioritetet që i përcaktuan kryetarët e bashkësive vendore.

Komuna e Kërçovës do të kushtojë vëmendje edhe bashkëpunimit rajonal me komunat e afërta për realizimin e projekteve nga kuptimi rajonal.

Përveç asaj që me këtë Program janë të definuara obligimet për rregullimin e tokës ndërtimore, ai është i hapur për ndryshim dhe plotësim dhe në të mund të kyçen edhe detyra tjera eventuale, nëse ka nevojë dhe nëse krijohen kushte dhe mjete financiare për realizimin urgjent të tyre në vitin 2026.

2. VËLLIMI I PUNËVE PËR PËRGATITJEN DHE PASTRIMIN E TOKËS NDËRTIMORE

Përgatitja dhe pastrimi i tokës ndërtimore përfshin:

- 2.1.** Përgatitje dhe sjellje të planeve urbanistike,
- 2.2.** Formimin e dokumentacioneve gjeodete,
- 2.3.** Përgatitjen e elaborateve për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore-juridike,
- 2.4.** Pastrimi i lokacioneve nga infrastruktura komunale ekzistuese,
- 2.5.** Zbatimi i studimeve të nevojshme gjeomekanike të parcelave ku do të ndërtohen objekte infrastrukture,
- 2.6.** Përgatitja e dokumentacionit për ndërtimin e objekteve infrastrukture,
- 2.7.** Përgatitja e Planit për komunikacion.

2.1. Përgatitja dhe sjellja e Planeve urbanistike

Sipas këtij Programi, do të urbanizohet toka ndërtimore në rajonin ndërtimor të Komunës së Kërçovës, në pajtim me Ligjin për planifikim hapësinor dhe urbanistik ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32/2020) dhe aktet nënligjore.

Komuna e Kërçovës në vitin 2026 do t'i hartojë planet vijuese urbanistike:

Planin e përgjithshëm urbanistik

- Plani i përgjithshëm urbanistik për qytetin e Kërçovës

Plane detale urbanistike

- PDU për lagjen PASHINË
- PDU për lagjen PASHINË E EPËRME
- PDU për lagjen PASHINË E POSHTME
- PDU për lagjen MBI PASHINË
- PDU për lagjen GORICA
- PDU për lagjen KOPAÇKA
- PDU për lagjen BIÇINCË
- PDU për lagjen ÇARSHIA E VJETËR
- PDU për lagjen KUTLLABICA-1
- PDU për lagjen KUTLLABICA – 2
- PDU për lagjen IVANIDOLL 1
- PDU për lagjen IVANIDOLL 2
- PDU për lagjen DEVEANA
- PDU për lagjen LLOZHIONICË
- PDU për lagjen ÇIFLIG
- PDU për lokalitetin KRUSHINË
- PDU për lagjen NËNVAROSH
- PDU për lagjen BALLA MËHALLË
- PDU për lagjen KALENDERICA 1
- PDU për lagjen KALENDERICA – 2
- PDU për lagjen KONJSKI LIVADI
- PDU për lagjen KARPOSH 3
- PDU për lagjen KARPOSH 1 dhe 2
- PDU për lagjen ZAGORJE
- PDU për lagjen NËNKRUSHINË 1
- PDU për lagjen NËNKRUSHINË 2
- PDU për lagjen zona industriale NËNKRUSHINË 3
- PDU për lagjen VRANESHTICË
- PDU për lagjen zona industriale PERËNDIM
- PDU për lagjen zona industriale PERËNDIM 1
- PDU për lagjen zona industriale PASHINË E EPËRME
- PDU për lagjen DEVIÇO
- PDU për lagjen 22 DHJETORI

Plane urbanistike për fshatëra

Në këtë vit do të fillohet hartimi i planeve urbanistike për fshatërat në sipërfaqje prej 200 ha. Përparësi do t'u jepet atyre vendbanimeve ku do të ketë interesim më të madh për ndërtim të objekteve afariste dhe banesore.

Plane urbanistike për jashtë vendbanimit

- Plane urbanistike për jashtë vendbanimit për rajonin e Komunës së Kërçovës në sipërfaqe prej 50 ha.

Projekte urbanistike

- Projekte urbanistike për rajonin e Komunës së Kërçovës në sipërfaqe prej 200 ha.

Plane urbanistike të financuara nga persona juridikë dhe fizikë

- Plane urbanistike të financuara nga persona juridikë dhe fizikë për rajonin e Komunës së Kërçovës.
- Projekte urbanistike të financuara nga persona juridikë dhe fizikë për rajonin e Komunës së Kërçovës.
- Plane urbanistike për rajonin e Komunës së Kërçovës, i cili ndryshim do të dalë konformë nenit 20, paragrafi 7 nga Ligji për veprim me objektet e ndërtuara pa leje ("Gaz. zyrtare e RM-së" nr.23/11,54/11,155/12,72/13,44/14,115/14,199/14,124/15,129/15, 217/15 31/16 dhe 190/17).

2.2. Formimi i dokumentacionit gjeodet

Sigurimi i shtresave të azhuruara gjeodete.

2.3. Përgatitja e elaborateve për zgjidhjen e marrëdhënieve pronësore-juridike

Komuna e Kërçovës në pajtim me Ligjin për eksproprijim, do të realizojë procedura për eksproprijimin e tokës dhe objekteve për hapjen e rrugëve, sipërfaqeve tjera publike qarkulluese dhe për pastrimin e lokacionit për ndërtimin e stacionit për pastrim. Në kuadër të këtyre procedurave, Komuna do t'i sigurojë të gjitha të dhënat e domosdoshme nga organet kompetente: të dhëna numerike, historinë e lëvizjes së parcelave dhe do të lidhë kontrata për përcaktimin e kompensimit për pronarët e mëparshëm, ndërsa mjetet për pagesë të këtij kompensimi do të sigurohen drejtpërdrejtë nga shfrytëzuesit me llogari të veçantë, me metodologji të përcaktuar paraprakisht. Eksproprijime prioritare në vitin 2025 do të jenë të gjitha ato parcelat që janë të përfshira me projektin e ndërtimit të kanalizimit në territorin e Komunës së Kërçovës-faza e dytë, i cili është i financuar nga IPA-2 programi.

2.4. Zbatimin e studimeve të nevojshme gjeomekanike të parcelave ku do të ndërtohen objekte infrastrukturore

Hulumtime themelore gjeomekanike do të kryhen për projektimin e objekteve për të cilët ka nevojë. Hulumtimet gjeomekanike do të finansohen nga investuesit e objekteve për të cilët do të kryhet hulumtimi.

2.5. Përgatitja e dokumentacionit për ndërtimin e objekteve infrastrukturore

Komuna e Kërçovës do ta përgatisë dokumentacionin e domosdoshëm për ndërtimin e objekteve nga infrastruktura komunale, të objekteve të cilat do të ndërtohen me mjete të veta të Komunës dhe objekte për të cilat do të kërkohen ndarje të mjeteve.

2.6. Përgatitja e Planit për komunikacion

Komuna e Kërçovës, nëse ka nevojë do të sjellë Vendim të ri për përcaktimin e regjimit të komunikacionit për rrugët kryesore në qytet, në pajtim me gjendjen faktike në terren, ose plan për komunikacionin për gjendjen e planifikuar.

3. VËLLIMI DHE SHKALLA E PAISJES SË TOKËS ME OBJEKTE NGA INFRASTRUKTURA KOMUNALE

Me vëllimin e paisjes së tokës ndërtimore nëkuptohet ndërtimi i objekteve të infrastrukturës, për shkak të qasjes së lirë në parcelat ndërtimore nga rruga publike, vendosjen e rrjetit të ujësjellësit, rrjetit të kanalizimit fekal dhe rrjetit elektrik me tension të ulët përmes pjesës së trafikut, ku graviton lokacioni i objektit.

Pajisja e tokës ndërtimore mund të zbatohet përgjithësisht ose pjesërisht në periudhën e kaluar ose në momentin kur rregullohet.

Nën shkallën e paisjes së tokës ndërtimore nënkuptohet shkalla e paisjes së kësaj toke me objekte nga infrastruktura komunale për plotësimin e konsumit të përbashkët dhe individual komunal.

Shkalla e rregullimit të tokës ndërtimore mund të jetë themelore, më e lartë ose më e ulët nga themeloria.

3.1. Shkalla themelore e rregullimit

Shkalla themelore e rregullimit paraqet paisje me:

- Qasje të lirë deri te parcelat ndërtimore nga rruga publike,
- Ndërtimin e rrjetit elektrik,
- Ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit,
- Ndërtimin e kanalizimit fekal,
- Ndriçimi i rrugëve.

3.2. Paisje plotësuese të tokës

Paisja plotësuese e tokës paraqet paisje me:

- Ndërtimin e rrugëve, trotuarëve, vendparkimeve, zonat e këmbësorëve dhe sipërfaqeve tjera (gjelbërimin publik, fushat me lojëra për fëmijë, terrenet sportive etj.) konformë planeve urbanistike.
- Ndërtimin e kanalizimit atmosferik,

Çdo lloj i objekteve nga 3.1. dhe 3.2, paraqet një shkallë të rregullimit të tokës ndërtimore, nëse toka është e paisur me më tepër objekte nga shkalla themelore e rregullimit, paraqet tokë me shkallë më të lartë të paisjes dhe e kundërta, në qoftë se, toka është e paisur me më pak objekte nga shkalla themelore e rregullimit, paraqet tokë me shkallë të paisjes më të ulët.

3.3 Paisja me objekte nga infrastruktura komunale

a). Paisja e objekteve nga infrastruktura komunale për shpenzime të përbashkëta komunale, në të cilat bëjnë pjesë:

- rrugët themelore në qytet (magjistrale, grumbulluese dhe sekondare),
- qasje të lirë deri te parcela ndërtimore nga rruga publike,
- ujësjellësit magjistrallë dhe primarë për sjelljen e ujit sëbashku me objektet përcjellëse,
- ujësjellësit magjistrallë dhe primarë për dërgimin e ujërave fekalë dhe atmosferikë sëbashku me objektet përcjellëse,
- sheshe të qytetit dhe sipërfaqe publike qarkulluese (trotuarë, zona për këmbësorë dhe sipërfaqe tjera publike të definuara me PDU),
- ndërtimin e ndriçimit publik,
- ndërtimin e gjelbërimeve publike.

Këto elemente paraqesin investime paraprake për paisjen e tokës ndërtimore, ndërsa marrin pjesë me 20% nga kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore.

b). Shpenzimet individuale komunale për çka është ekzekutuar ose do të ekzekutohen:

- ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit sekondar nëpërmjet rrugës në të cilën gravitojnë lokacioni për ndërtimin e objektit,
- ndërtimin e rrjetit të kanalizimit fekal sekondar deri te puseta më e afërt, përmes rrugës në të cilën graviton lokacioni për ndërtimin e objektit,
- ndërtimin e rrjetit sekondar me tension të ulët përmes rrugës në të cilin graviton objekti.

3.4. Paisja me objekte nga infrastruktura komunale në kufijtë e parcelës ndërtimore

- Rregullimin e tokës ndërtimore në kufijtë e parcelës ndërtimore me infrastrukturë komunale dhe të komunikacionit si dhe rregullimin paralel që e kryen ndërtuesi.

- Projektimin dhe ndërtimin e rrjetit infrastrukturor për tension të lartë, instalim tjetër dhe objekte, trafostacione ose pjesëmarrje në to, ndërtuesi e rregullon në pajtim me pëlqimin energjetik të dhënë nga EVN-ja.

- Nëse objektet e ndërtuara nga infrastruktura komunale ngelin në kufijtë e parcelës ndërtimore të ndërtuesit dhe nën objektet të cilat i ndërton, ndërtuesi patjetër duhet të kërkojë pëlqim me shkrim nga organi kompetent komunal, i cili atë e jep në bazë të mendimit nga ndërmarrja komunale gjegjëse. Shpenzimet për mbrojtjen e atyre objekteve i bartë pronari i tokës, përkatësisht ndërtuesi.

- Shpenzimet për rivendosje të objekteve ekzistuese të infrastrukturës komunale të cilat pengojnë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve, në lartësi deri në 20% nga çmimi i kompensimit për rregullimin komunal për ndërtimin e objekteve janë barrë e komunës. Në qoftë se, këto shpenzime janë më të mëdha, diferencën e bartë ndërtuesi i lokacionit konkret.

- Shpenzimet për studim gjeomekanik i bartë ndërtuesi, gjithashtu, ai obligohet t'i kompensojë komunës shpenzimet e bëra paraprake për pastrimin e parcelës ndërtimore.

- Lidhjet e objektit në infrastrukturën sekondare janë obligime të ndërtuesit.

3.5. Shkalla më e ulët e rregullimit të tokës ndërtimore

Shkallë e këtillë e rregullimit është planifikuar në vendbanimet (fshatërat) në territorin e Komunës së Kërçovës dhe sipas kësaj, komuna ka obligim që t'i finansojë hartimet dhe sjelljet e Planeve detale urbanistike për vendbanimet dhe dokumentacionin teknik për objektet infrastrukturorë. Ndërtimi i tërë infrastrukturës komunale do të kryhet me vetëfinancim të qytetarëve dhe me mjete të Buxhetit të komunës dhe me donacione tjera qeveritare ose jo qeveritare. Për shkallën e këtillë të rregullimit, konformë zonës në të cilën ndodhet vendbanimi paguhet kompensim për rregullimin komunal.

4. BURIMET E FINANCIMIT TË PROGRAMIT

Financimi i Programit do të bëhet nëpërmjet burimeve vijuese të mjeteve:

1	Obligime të pa paguara nga vitet e kaluara		198.000.000,00	
2	shitja e objekteve në pronësi të Komunës dhe të ardhura nga shitja e tokës		21.000.000,00	
3	kompensimi nga rregullimi komunal		61.000.000,00	
4	Tatime dhe taksa		79.000.000,00	
5	ndriçimi i rrugëve		30.000.000,00	
6	pjesëmarrje e qytetarëve, mjete republikane, mjete nga donacionet e jashtme dhe investime		562.712.900	
	Gjithsej:		951.712.900,00	

5. LLOGARITJA E SHPENZIMEVE PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE

Kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore i përfshin shpenzimet vijuese:

Shpenzime për punët përgatitore në rregullimin e tokës ndërtimore

Shpenzimet për punë përgatitore në rregullimin e tokës ndërtimore i përfshijnë të gjitha aktivitetet që i ndërmerr Komuna në pjesën e:

- Financimit në përgatitjen e planeve urbanistike në pajtim me ligjin,
- Punë gjeodete,
- Përgatitjen e projekteve kryesore të infrastrukturës,

Shpenzime për rregullimin e tokës ndërtimore

Shpenzimet për rregullimin e tokës ndërtimore i përfshijnë të gjitha aktivitetet të cilat i ndërmerr Komuna në pjesën e:

- ndërtimi i rrugëve, trotuarëve, vendparkimeve dhe rregullimit të sipërfaqeve me gjelbërim,
- ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit, kanalizimit fekal dhe atmosferik,
- ndërtimi i objekteve të tensionit të ulët për furnizim me energji elektrike dhe për ndriçim publik të rrugëve.

Lartësia e kompensimit përcaktohet si shpenzime mesatare për rregullimin dhe paisjet e lokacionit. Përderisa shpenzimet reale për rregullimin dhe paisjen e lokacionit konkret janë më të larta nga mesataret e përcaktuara me llogaritjen pjesëmarrja e investuesit zmadhohet deri në lartësinë e shpenzimeve reale dhe do të rregullohen me aneks të Kontratës.

6. LARTËSIA E KOMPENSIMIT PËR RREGULLIMIN E TOKËS NDËRTIMORE DHE NDARJA E TIJ

Për rregullim dhe paisje të tokës ndërtimore në rajonin ndërtimor të Komunës së Kërçovës me objektet e infrastrukturës komunale paguhet kompensim për rregullim të tokës ndërtimore. Për lartësinë e kompensimit dhe shkallën e paisjes së lokacionit, do të lidhet kontratë e veçantë ndërmjet Komunës së Kërçovës dhe investuesit të objektit ndërtimor.

Kompensimi për rregullim komunal do të paguhet për të gjitha objektet banesore, afariste, publike, prodhuese dhe zejtare, garazhe me kate, objekte sportive të mbuluara, tregje të hapura, depo të hapura, magazina në sipërfaqe të hapur, baza asfalti dhe objekte të ngjajshme.

Nga pagesa e kompensimit për rregullim komunal do të lirohen të gjitha objektet fetare, përveç objekteve të tyre përcjellëse për të cilët do të paguhet kompensim sipas llojit dhe qëndrimit të hapësirës.

Kompensimi për rregullim komunal nuk do të llogaritet për: rrugica, rrugë, trotoare, ura, vendparkime në hapësirë të hapur, parqe, infrastruktura nëntokësore dhe ajrore për të cilat investitorë është komuna ose shteti.

6.1. Llogaritja e lartësisë së kompensimit për rregullimin komunal

Lartësia e kompensimit për rregullim komunal për vitin 2026, do të caktohet sipas përqindjes adekuate nga çmimi mesatar ndërtimor në 1m² hapsirë banesore me muajin bazë dhjetor 2024 paraqet 26.069,00 den. dhe i njejti do të korrigjohet çdo të 10-tinë muaj, në pajtim me indeksin e rritjes së çmimeve me pakicë, të shpallur në Entin republikan të statistikës.

Kompensimi do të paguhet konformë çmimit i cili vlen në ditën e lidhjes së kontratës.

Në çmimin e kompensimit për rregullim komunal nuk janë llogaritur shpenzimet për ekspropriim dhe depozedim dhe ato do të vlejné dhe realizohen me pjesëmarrjen e shfrytëzuesve të drejtpdrejtë dhe do të krijojnë kushte për realizimin e PDU-ve dhe ajo në mënyrë proporcionale sipas pjesëmarrjes në sipërfaqet e ndërtuar ose të parashikuara në mënyrë maksimale e cila është lëndë e depozedimit dhe objekteve që janë lëndë e ekspropriimit. Kompensimi për depozedim mundë të kompenzohet me dhënien e tokës në zotërim (posedim) në pronësi të ndërtuesit, e cila hyn në sipërfaqen e rrugës përkatëse.

Lidhja e çdo objekti në rrjetin rrugor (ujësjellësin, kanalizimin, rrjetin elektrik) do të jetë obligim i shfrytëzuesit të drejtpërdrejtë.

6.2. Mënyra e llogaritjes së sipërfaqeve për përcaktimin e kompensimit për rregullim komunal

Mënyra e llogaritjes të kompensimit për rregullim komunal është përcaktuar në pajtim me nenin 46 nga Ligji për tokën ndërtimore, ("Gaz. zyrtare e RM" nr.15/15, 98/15, 193/15, 226/15, 31/16, 142/16, 190/16 dhe "Gazeta zyrtare e RMV" nr.275/19, 101/21, 153/23, 61/24, 224/24 dhe 233/24) dhe Rregulloren për shkallën e paisjes së rregullimit të tokës ndërtimore dhe mënyrës për llogaritje të shpenzimeve për rregullim të tokës ndërtimore sipas shkallës së rregullimit ("Gaz. zyrtare e RM" nr.193/16, 72/18 dhe 16/22).

Lartësia e shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore llogaritet në bazë të sipërfaqes së re shfrytëzuese e cila do të ndërtohet, dhe e cila përfaqëson grumbull të sipërfaqeve ne neto në m² dhe të

sipërfaqeve të dyshemes për objektet, konformë projektit të vërtetuar dhe aneksit të projektit themelor, të shumëzuar me koeficientët vijuesë.

6.2.1 Kompensim për rregullim komunal për ndërtim të objekteve

1. OBJEKTE BANESORE

- sipërfaqe banesore koeficient 1,0;
- sipërfaqe banesore nën mbulesë me lartësi konstruktive të katit (nga pllaka deri te pllaka e plafonit ose konstrukcion tjetër) deri me 2,50 m koeficient 0,2;
- sipërfaqe e mbyllur nga tri anë 0,4;
- sipërfaqe e mbyllur nga dy anë 0,3;
- ballkone, terraca 0,2;
- sipërfaqe të përbashkëta kaluese të nevojshme, pasazhe 0,2;
- sipërfaqe ndihmëse në bodrum dhe lëndë djegëse dhe qilarë në suteran dhe përdhese me sipërfaqje deri më 10m² me koeficient 0,3, ndërsa sipërfaqet e mbeturame koeficient 1,0;
- trafostacione deri me 35 kv. në objekt dhe jashtë tij 0,3
- hapsirë për shkallë dhe komunikime të përbashkëta, 0,3;
- vende për roje, për drejtues, lokale për mjeshtër 0,5;
- vende parkimi dhe garazha në bodrum, suteran dhe përdhese deri më 18 m² për çdo njësi në objekt, koeficienti është 0,1, ndërsa për rritjen e sipërfaqes 0,3 në bodrum dhe 1,0 në suteran dhe përdhese;

2. OBJEKTE AFARISTE DHE PUBLIKE

- Lokale koeficient 1,0;
- Magazina 0,5;
- Magazinë për sipërfaqe deri me 50% nga sipërfaqja e lokalit afarist koeficienti 0,5 për sipërfaqe të zmadhuar koeficienti 1,0;
- Galeri të brendëshme të hapura vetëm në një anë 0,5;
- Lokale ndihmëse, për vendosjen e lëndëve djegëse, qilarë 0,3;
- Trafostacione deri në 35 kv, në objekt dhe jashtë tij 0,4;
- Sipërfaqe depoje dhe për komunikim të përbashkët 0,5;
- Vendëparkime dhe garazha 0,1;
- Lokal i mbyllur nga tri anë 0,5;
- Lokal i mbyllur nga dy anë 0,4;
- Ballkon, terrasa 0,3;
- Sipërfaqje e hapur dhe e mbuluar (strehë etj) 0,3;

3. OBJEKTE TJERA

- Garazha në kate 0,05;
- Oobjekte sportive të mbuluara 0,5;
- Objekte sportive të hapura 0,3;
- Pishina dhe stacione pastrimi për 50% nga sipërfaqja e lokalitetit 1,0;
- Tregje të hapura për 30% të sipërfaqes së lokalitetit 1,0;
- Pishina 0,2;
- Trafostacione mbi 35 kv. 1,0.

4. PËR OBJEKTE TË KLASËS SË DESTINUAR “G”

- G1 për industrinë e rëndë dhe ndotëse 0,05;
- G2 për industrinë e lehtë jondotëse 0,01;

- G3 servise 0,01
- G4 depo 0,01.

5. PËR POMPË BENZINI DHE PËRMBAJTJE NDIHMËSE TË SAJ (shitore, kafeteri dhe restorante, autoservisë, autosallone, lokale ndihmëse)

- hapësira për shitje 1,0
- hapësira për shërbime 1,0

6. PËR OBJEKTET E GRUPIT DHE QËLLIMIT TË DESTINUAR “B-5” (komplekse hotelierike dhe turistike, komplekse për pushim) DHE PËR OBJEKTE TË GRUPIT TË KLASIT TË DESTINUAR “A-4” (hotele, motele, shtëpi alpiniste dhe të gjahëtarëve)

- të gjitha lokalet 0,05.
- për ndërtesat për arsim të lartë, koeficienti për të gjitha hapësirat është 0,5
- për objektet e kulturës, koeficienti për të gjitha hapësirat është 0,01

7. PËR OBJEKTE INFRASTRUKTURE NË LINJË (Linja nëntokësore dhe ajrore ku mbajtësit janë subjekte private ose subjekte të përziera me pronësi dominuese private)

PËR OBJEKTET INFRASTRUKTURE NË LINJË (përçues nëntokësorë dhe ajrorë ku pronarë janë subjekte private ose subjekte të përziera me pronësi dominante private) vlera e kompenzimit për rregullimin e tokës ndërtimore deri 1km është 5% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 1-2km – 5.5% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 2-3km – 6% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 3-4km – 6.5% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 4-5km – 7% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 5-6km – 7.5% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 6-7km – 8% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 7-8km – 8.5% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 8-9km – 9% nga çmimi i ndërtimit

Për objekte infrastrukturore në linjë prej 9-10km – 9.5% nga çmimi i ndërtimit

Për projekte për gjatësi mbi 10km 10% nga çmimi i ndërtimit

8. PËR OBJEKTE TË CILAT PRODHOJNË ENERGJI ELEKTRIKE NGA BURIME TE RINOVUESHME TË ENERGJISË

- për objekte për prodhimin e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (biokarburant, biomasë, energji gjeotermale dhe hidroenergji) 0,01

- për objekte për prodhim të energjisë elektrike nga energjia diellore (panelet fotovoltaike), për 50% të hapësirës së parcelës ndërtimore, 1 me çmim 100 den/m²

- për objektet për prodhimin e energjisë elektrike nga energjia e erës, lartësia e shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore është 1.200.000 den për secilin turbinë në pajtim me projektin themelor.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij nënkapitulli, në sipërfaqen e re të dobishme që do të ndërtohet sipas dokumentacionit të projektit të miratuar, nuk llogariten sipërfaqet e:

kanaleve të instalimeve;

boshteve të ashensorëve;

hapësirave të dyerve;

parkimeve të hapura;

rezervuarëve nëntokësorë dhe

objekteve të mbrojtura si trashëgimi kulturore.

(3) Shpenzimet për rregullimin e tokës ndërtimore për shkallë më të lartë të rregullimit të tokës ndërtimore me objektet e infrastrukturës komunale në pajtim me pjesën e 2 (nga Rregullorja për shkallën e rregullimit të tokës ndërtimore me objekte të infrastrukturës komunale), mund të rriten nëse janë të ndërtuara rrjete infrastrukturore komunale të theksuara në nenin 2, paragrafi (3) të rregullores, për më tepër 20% nga shpenzimet e përcaktuara për shkallën themelore të rregullimit të tokës ndërtimore me objekte të infrastrukturës komunale.

(4) Kompensim për rregullim komunal llogaritet për ndërtime të:

- **objekteve banesore, objekteve banesore-afariste.**

- **objekteve komerciale** (tregtisë, turizmit, hotelierisë, shtëpive të mallrave, shitoreve, barnatoreve, pompa të benzinës dhe pompa për shitjen e gazit, përfaqësive tregtare dhe turistike, hoteleve, moteleve, kafeneve, ordinancave, trafostacionet etj.).

- **objekte administrative drejtuese, objekteve prodhuese dhe ndërtesave administrative, dyqaneve zejtare,** (objekteve industriale, sallave të fabrikave, depove, frigoriferëve, servisëve, stacioneve hekurudhore dhe të autobusëve, hapësirave të mbyllura të magazinës),

- **objekte publike** (objekte joekonomike, institucione arsimore, shkolla, shtëpi kulturore dhe artistike, ndërtesa shëndetësore, stacione veterinarie),

- **objekte nga mbrojtja speciale** (çerdhe të fëmijëve, foshnjore, shtëpi të pleqëve).

- **Objekte tjera:** (Baza asfalti dhe betoni, garazha dhe kate, depo të hapura, magazina në teren të hapur dhe tregje të hapura).

Kompensimi për rregullim komunal për të gjitha llojet e objekteve do të paguhet konformë përqindjeve të përcaktuara në tabelën që vijon:

		komoditet – bonitet i lokalitetit (kompleksi)			
zona	komunale themelore	hapësirë banesore	Gjithsej hapësirë banesore	Hapësirë afariste, publike dhe tjetër	Gjithsej hapësirë afariste, publike dhe tjetër
ekstra	10,70 %	5,00 %	15,70	14,00 %	24,70 %
e para	10,45 %	3,00 %	13.45	11,00 %	21,45 %
e dyta	10,20 %	2,00 %	12.20	10,00 %	20,20 %
e treta	9,95 %	1,75 %	11.70	9,00 %	18,95 %
e katërta	9,70 %	1,50%	11.20	8,00 %	17,70 %

Në qoftë se, nuk janë të zgjidhura marrëdhëniet pronësore juridike për sigurim të qasjes deri te parcela, është obligim i komunës të ngrej procedurë përkatëse për depozitim, ndërsa shpenzimet për rregullim komunal do të rriten për shumën e llogaritur në pajtim me pikën 6.1 të Programi. Këto shpenzime do të llogariten kur do të krijohen kushtet për realizimin e PDU-së.

Çmimi i tokës për m² i cili do të jetë lëndë depozitimi, do të caktohet në procedurë para Seksionit për marrëdhënie pronësore juridike ose para gjykatës kompetente. Procedurën do ta zhvillojë përfaqësuesi i autorizuar i Komunës së Kërçovës. Shpenzimet për sigurim të dokumentacionit të nevojshëm nga shërbimet kompetente, do të jenë ngarkesë e Komunës.

6.2.2. Kompensimi për rregullim komunal për ndërtim shtesë dhe mbindërtim

Për ndërtim shtesë dhe mbindërtim të objekteve ekzistuese (të ndërtuara me leje për ndërtim dhe të njëjtit kanë të siguruar fletëpronësinë për objektin në etazh), do të llogaritet kompensimi për rregullim komunal në këtë mënyrë:

- Për ndërtim shtesë dhe mbindërtim me sipërfaqe neto më të vogël ose të njëjtë nga sipërfaqja e objektit ekzistues, paguhet kompensimi me lëshim prej 50%,

- Për ndërtim shtesë dhe mbindërtim me sipërfaqe neto të zmadhuar nga objekti ekzistues për pjesën e sipërfaqes ekzistuese të objektit, do të paguhet kompensim me lëshim për 50%, ndërsa për sipërfaqen e zmadhuar do të paguhet kompensim si për objekt të ri.

Për objekte të shënuara në bazë të Ligjit për përcaktimin e statusit juridik të objekteve të ndërtuara pa leje, alinetë 1 dhe 2 të kësaj pike nuk zbatohen edhe për tërë sipërfaqen e cila do të ndërtohet shtesë ose mbindërtohet paguhet kompensim për rregullim komunal si për objekt të ri.

6.2.3. Kompensim për rregullim komunal për rikonstruim të objekteve ekzistuese ose ndërtim i objektit të ri në vend të objektit ekzistues, i cili mënjanohet me ndërtimin e objektit të ri

Nën rikonstruim të objektit ekzistues nënkuptohet intervenimi ndërtimor me të cilin bëhet ndryshim i sistemit konstruktiv të objektit. Për rikonstruimin e objektit ekzistues dhe për ndërtimin e objektit të ri në vendin e objektit ekzistues, gjatë përlllogaritjes të shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore, nga sipërfaqja e re për përdorim hiqen shpenzimet me të njëjtat qëllime të përcaktuara me Kontratën për rregullim komunal ose me fletëpronësi për objektin i cili rikonstruohet ose mënjanohet me ndërtimin e objektit të ri në parcelën e njëjtë.

Në raste kur për objektin ekzistues që duhet të rikonstruohet ose mënjanohet për ndërtimin e objektit të ri në parcelën e njëjtë, ndërsa në fletëpronësi objekti ekzistues është i shënuar pas bazës së Aktvendimit për legalizim, gjatë përlllogaritjes së lartësisë të shpenzimeve për rregullimin e tokës ndërtimore, nga shuma e përgjithshme e kompensimit për objektin e ri hiqet shuma e cila është paguar gjatë procedurës për përcaktimin e statusit juridik për objektin e paligjshëm.

6.2.4. Kompensim për rregullim komunal për objekte në vendbanime në rajonin e Komunës së Kërçovës

Investuesit e objekteve banesore, publike, afariste, ekonomike, prodhuese dhe të tjera në ataret e vendbanimeve në territorin e Komunës së Kërçovës, do të paguajnë kompensim për punët përgatitore në rregullimin e tokës ndërtimore. Kompensimi do të përcaktohet si koeficient nga kompensimi për rregullimin komunal për zonën e IV të qytetit në varësi nga ajo në cilën zonë të rregullimit ndodhet vendbanimi, edhe të:

- Zona e parë e vendbanimit 15%
- Zona e dytë e vendbanimit 10%
- Zona e tretë e vendbanimit 3%

Mjetet do të shfrytëzohen për hartimin e planeve urbanistike, hartimin e dokumentacionit teknik për ndërtim të infrastrukturës, udhëheqjen e procedurës për sigurimin e mjeteve për ndërtim të infrastrukturës etj.

6.2.5. Kompensim për rregullim komunal për objektet e ndërtuara pa leje dhe të përfshira në PDU

Kompensimi për objekte të ndërtuara pa leje do të llogaritet konformë Ligjit për veprim me objektet e ndërtuara pa leje (“Gaz. zyrtare e RM-së” nr. 23/11, 54/11, 155/12, 72/13, 44/14, 115/14, 199/14, 124/15, 129/15, 217/15, 31/16 dhe 190/17 dhe “Gazeta zyrtare e RMV-së” nr.174/21).

Në qoftë se, objekti për të cilin paguhet kompensim në pajtim me Ligjin e lartpërmendur, nuk është i pajisur me infrastrukturë, kjo do të jetë obligim i investitorit.

Për të gjithë objektet e paligjshëm për të cilët investitorët në komunat e mëparshme që janë të bashkuara në Komunën e Kërçovës, për marrjen e pëlqimit për lidhje të objektit në rrjetin e infrastrukturës, kanë paguar shumë të caktuar të mjeteve financiare, si kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore për sipërfaqe të caktuar të objektit, me çka bashkangjisin provë me kërkesën për legalizim, ndërsa pagesa është kryer para hyrjes në fuqi të Ligjit për legalizim, u pranohet sipërfaqja për të cilën u është llogaritur kompensimi. Në rast të sipërfaqes së zmadhuar të ndërtuar, përllogaritet dhe veprohet në pajtim me nenin 20-a të Ligjit për legalizim.

6.2.6. Kompensim për rregullim komunal për ndërtim të objekteve në lokacione me vetëfinansim për rregullimin e tokës ndërtimore

Në rast të lokacionit të përgatitur me infrastruktur komonale ku shpenzimet reale janë më të mëdha nga ato mesatare, atëherë investuesi është i obliguar që të paguaj 20% nga çmimet e verifikuara mesatare për llojin e objektit për të cilin llogaritet kompensim. Kompensimi i paguar përcaktohet për mjetet e investuara në objektet e infrastrukturës komonale nga konsumi i përbashkët.

Ndërtimi i infrastrukturës komonale sekondare do të jetë në tërësi në shpenzim të investuesit ndërsa ndërtimi do të bëhet nën mbikëqyrje të Seksionit për veprimtari komonale në Komunën e Kërçovës.

6.2.7 Kompensim për rregullim komunal për parcelat të cilat nuk kanë shkallë themelore të rregullimit

Për objektet që ndodhen në parcela ndërtimore në territorin e qytetit të Kërçovës, të cilat pjesërisht nuk janë të pajisura me nivelin themelor të rregullimit ose në bazë të mendimit të institucionit përgjegjës për lidhjen e objektit me infrastrukturën përkatëse nuk ka kushte teknike për kyçje, kompensimi për rregullimin komunal do të llogaritet si më poshtë:

- Për objektin konkret, nëse **nuk ka** mundësi teknike për kyçje në kanalizimin fekal, do të zbatohet zbritje prej 20% nga kompensimi total për rregullimin e tokës ndërtimore.

6.2.8 Kompensim për rregullim komunal për ridestininim dhe adaptim

Për ndryshimin e destinimit të një objekti ekzistues (të ndërtuar me Leje Ndërtimi ose që ka të siguruar certifikatë pronësie etazhore për objektin), kompensimi për rregullimin komunal do të llogaritet si diferencë ndërmjet kompensimit për destinimin e ri të parashikuar dhe kompensimit për destinimin ekzistues të objektit.

Në rast të ndryshimit të destinimit nga hapësirë banimi në hapësirë afariste, paguhet një herë diferenca deri në shumën e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për hapësirë afariste.

Në rast të ndryshimit të destinimit nga hapësirë afariste në hapësirë banimi, diferenca e kompensimit të paguar nuk kthehet.

